



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.1692, datë 19.09.2011

Për

“Shqyrtimin e ankimimit administrativ të Albtelecom sh.a në lidhje me Aktin Administrativ, Vendimi nr. 1650, datë 29.06.2011 të Këshillit Drejtues të AKEP “Për miratimin e dokumentacionit për implementimin dhe Rregulloren e Zgjedhjes dhe Parazgjedhjes së Bartësit”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 19.09.2011, sipas procedurës së përcaktuar në Ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

Shqyrtimin e ankimimit administrativ të Albtelecom sh.a në lidhje me Aktin Administrativ, Vendimi nr. 1650, datë 29.06.2011 të Këshillit Drejtues të AKEP “Për miratimin e dokumentacionit për implementimin dhe Rregulloren e Zgjedhjes dhe Parazgjedhjes së Bartësit”,

BAZA LIGJORE:

1. Germa ç) e nenit 8, neni 31 e vijues, pika 1 e nenit 114 dhe pika 1 e nenit 115 te ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (*ligji nr. 9918*);
2. Pika 2 e nenit 137, neni 138 e vijues i ligjit nr. 8485, date 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (*K.Pr.A*);
3. Neni 43 i ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (*ligji nr. 9918*);

4. Rregullore nr. 23, datë 29.06.2011 “Për Zgjedhjen dhe Parazgjedhjen e Bartësit”. miratuar me Vendim nr. 1650, datë 29.06.2011 të Këshillit Drejtues të AKEP;
5. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendëshme të AKEP, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918 (*Rregullorja e Brendshme*);
6. Vendimi nr.1650 datë 29.06.2011 i Këshillit Drejtues të AKEP “Për miratimin e dokumentacionit për implementimin dhe Rregulloren e Zgjedhjes dhe Parazgjedhjes së Bartësit”, (*Vendimi nr. 1650*),

K Ë SH I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Shkresa nr. 3808 prot, datë 18.08.2011 e Albtelecom sh.a, (AKEP: nr. 1381 prot, datë 18.08.2011), (*Ankim Administrativ*);
2. Vendimi nr.1650 datë 29.06.2011 i Këshillit Drejtues të AKEP “Për miratimin e dokumentacionit për implementimin dhe Rregulloren e Zgjedhjes dhe Parazgjedhjes së Bartësit”, (*Vendimi nr. 1650*);
3. Projektvendim i Këshillit Drejtues të AKEP për Shqyrtimin e ankimit administrativ të Albtelecom sh.a në lidhje me Aktin Administrativ Vendimi nr. 1650, datë 29.06.2011 të Këshillit Drejtues të AKEP “Për miratimin e dokumentacionit për implementimin dhe Rregulloren e Zgjedhjes dhe Parazgjedhjes së Bartësit”;
5. Relacion shpjegues mbi projektvendimin (*Relacioni*);
si dhe,
6. Diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

1. Albtelecom me shkresën nr. 3808 prot, datë 18.08.2011 (AKEP nr. 1381 prot, datë 18.08.2011) brënda afatit ligjor të përcaktuar në nenin 140 të ligjit nr.8485, ka bërë ankim administrativ për shfuqizimin e Aktit Administrativ Vendimi nr. 1650, datë 29.06.2011 të Këshillit Drejtues të AKEP “Për miratimin e dokumentacionit për implementimin dhe Rregulloren e Zgjedhjes dhe Parazgjedhjes së Bartësit”;
2. Albtelecom thekson se, përpara se të vendosen detyrimet për zgjedhjen dhe parazgjedhjen e bartësit, apo detyrimet për terminimin apo origjinimin e thirrjeve ndërkombëtare është e nevojshme të saktësohet koncepti për bartësin, i cili duhet të përmbushë një minimum kushtesh që të mund të shfaqet i besueshëm si i tillë pa rezikuar që Shqipëria të shihet si një destinacion dhe origjinë e pabesueshme për operatorët ndërkombëtarë;
3. Për sa më sipër Albtelecom kërkon që të plotësohen nga bartësi (Carrier) kriteret si më poshtë vijon:

- Bartësit kombëtar dhe ndërkombëtar të kenë kod ndërkombëtar sinjalizimi (ISPC) i cili do tu mundësojë operatorëve ndërkombëtar me një vendodhje në mënyrë që funksionet e kanaleve të sinjalizimit mund të ndodhin mes operatorëve ndërkombëtar;
 - Bartësit kombëtar dhe ndërkombëtar të autorizuar ti paguajnë AKEP-it një pagesë me marrjen e autorizimit nga AKEP, përveç pagesës për frekuencat dhe për numeracion;
 - Bartësit kombëtar dhe ndërkombëtar të autorizuar të duhet të vendosin lidhje direkte me më shumë se një carrier të madh ndërkombëtar nëpërmjet rrugëve të mbrojtura;
 - Bartësit kombëtar dhe ndërkombëtar të autorizuar të duhet të vendosë pajisje dhe facilitete të cilat mbështesin plotësisht portabilitetin e numrit siç kërkohet nga rregullat e AKEP;
 - Bartësit kombëtar dhe ndërkombëtar të autorizuar të duhet të realizojnë plotësisht kërkesat ligjore me përgjimin e ligjshëm për të gjitha thirrjet e tranzituara në rrjetin e tyre dhe në rrjetet e tjera;
 - Të garantojë CLIP transparent;
 - Të garantojnë mbështetje të plotë për thirrjet e emergjencës;
 - Të mbajnë përgjegjesi për përputhshmërinë me rregullimet e AKEP mbi QoS;
 - Të kenë mbulim me transmetimin e tyre dhe akses në rrjetet në të gjithë Republikën e Shqipërisë;
 - Të paraqesin prova që janë të aftë të hyjnë dhe të mbajnë marrëdhënie kontraktore me operatorë të tjerë kombëtar apo ndërkombëtar;
 - Të kenë bërë me shumë se 50 milion euro investime në infrastrukturën e rrjeteve të komunikimeve elektronike përpara lëshimit të autorizimit dhe të marrin përsipër të investojnë më shumë se 20 milion euro në këtë infrastrukturë për tre vitet e ardhshme;
 - Të kenë më shumë se 100.000 pajtimtarë të shërbimeve elektronike në Shqipëri;
4. Albtelecom pasi u njoh dhe me qëndrimin e AKEP pas komenteve të bëra këtij dokumenti nga ana e Albtelecom gjatë konsultimit publik parashtron si më poshtë:

Së pari, në lidhje me implementimin e Z(P)B shprehet se nuk është dakord që implementimi i këtij detyrimi të realizohet në mënyrë diskriminuese vetëm për Albtelecom sh.a, por ky detyrim ti vendoset edhe operatorëve të tjerë, për sa kohë që ky detyrim në zbatim të parimeve të ligjit për komunikimet elektronike vendoset në përfitim të përdoruesit fundorë;

Së dyti, Albtelecom sqaron se afati i lënë për Fazën I (e parë) duke filluar nga data 15.10.2011 është absolutisht i pamundur objektivisht për të realizuar nga ana e Albtelecom për arsye e mëposhtme:

- Kërkohen investime të nevojshme për të mbështetur implementimin e shërbimit Z(P)B;
- Kërkohen përgatitje respektive në sistemet e Albtelecom (centrale, rrjete, billing);
- Duhet të përgatiten rrjetet përkatëse në sistemin e billingut;
- Duhet të përcaktuar procedurat dhe stafi përkatës në aspektin administrativ që do të menaxhojë Z(P)B, duke filluar që nga marrëdhënia me operatorin e deri tek marrëdhënia me pajtimtarin;
- Duhet trajtuar stafi përkatës për implementimin dhe menazhimin e Z(P)B dhe të hartohen rregulloret e brendshme përkatëse mirëfunksionimin dhe implementimin e Z(P)B;

Për sa më sipër Albtelecom thekson se e ka të pamundur teknikisht fillimin e fazës së parë të paktën deri më datë 1.12.2011.

Së treti, për sa i takon tarifave Albtelecom kërkon që të aplikohen pagesat sipas kategorive të mëposhtme:

- Për çdo operator një herë për vendosjen fillestare të aksesit në rrjet për këtë shërbim për të konfiguruar sistemet për të mbështetur Z(P)B për këtë operator;
 - Pagesa për origjinimin e thirrjeve;
 - Pagesa mujore ndaj operatorit duke filluar që nga data kur është bërë transaksioni i parë për të mbuluar kostot e menaxhimit “life” në vazhdimësi të këtij produkti nga ana e operatorit të aksesit;
 - Pagesa për administrimin e kërkesave (aktivizimin, ndryshimin, anulimin, pezullimin) e Z(P)B për çdo pajtimtar të kërkuar (aktivizimin, ndryshimin, anulimin, pezullimin) e Z(P)B;
 - Pagesë për minut (surcharge per minute) që rrjeti të rikuperohet nga kostoja e shkaktuar rrjetit për të mundësuar Z(P)B, kjo pagesë të vazhdojë për një periudhë 5 vjeçare (e ndryshueshme) deri sa të rikuperohen kostot e tij.
- Albtelecom thekson se, mbështetur ne Rregullore, Autorizimi i operatorit duhet të përfshijë specifikisht shërbimin për të cilin ai do të rrugëzojë nëpërmjet Z(P)B, si dhe operatori duhet ti nenshtrohet kriterëve të tjera kualifikuese sic mund të jete cilesiA e shërbimit dhe afesia për të marre persiper detyrime kontraktuale.

Së katërti, Albtelecom kërkon që afati 10 ditor i përcaktuar nga neni 4, pika 3 të bëhet 20 ditë, kjo për shkak se procesit të përshkruar në këtë nen i duhet objektivisht më shumë kohë për:

- Vlerësimin e saktë dhe në përputhje me aktet rregullatore i kërkesës nga operatori bartës;
 - Verifikimin e kontratës së pajtimtarit për të cilën kërkohet të bëhet implementimi i kodit të bartësit;
 - Verifikimi i situatës së pajtimtarit;
 - Konfigurimet përkatëse në centralet respektive dhe në sistemet përkatëse të Albtelecom;
 - Koordinimi në aspektin administrativ i të gjithave sa më sipër duke qënë se këto procese kërkojnë bashkëpunimin e disa departamenteve dhe rajoneve në të njëjtën kohë;
5. Albtelecom sh.a nëpërmjet Ankimit Administrativ bazuar në pikën 1 të nenin 138 të dhe gjurmën c) të nenit 146 të K.Pr.A kërkon :
- pezullimin e zbatimit të Vendimit nr. 1650 dhe
 - pranimin e ankimit administrativ duke e ndryshuar atë .

6. Për sa më sipër ankimuar, AKEP i vlerëson se :

- **së pari**, e çmon se nuk është e nevojshme për të ndryshuar qëndrim për mënyrën e implementimit të Z(P)B, duke filluar me Albtelecom. Për sa i përket Z(P)B në rrjetet celulare dhe referencave me direktivat e KE, ky diskutim është bërë tashmë në dokumenta të tjerë si analiza e tregut të telefonisë celulare në vitin 2010, si dhe AKEP është shprehur njëherë për këtë pikë dhe ka dhënë disa sqarime shtesë në

dokumentin final “Implementimi i Zgjedhjes së Bartësit dhe Parazgjedhjes së Bartësit”.

- **së dyti**, AKEP duke ri-marrë në konsideratë pretendimet e Albtelecom për afatin e implementimit të Z(P)B, e gjykon të arsyeshme të pranojë datën 1.12.2011 (sipas propozimit të vet Albtelecom) si afat për implementimin efektiv të fazës së parë të Z(P)B, nga data 15.10.2011 që u vendos në Vendimin nr. 1650, datë 29.06.2011. Ky ndryshim nuk prek implementimin e fazës së dytë, që duhet të kryhet nga Albtelecom duke filluar nga 1.05.2012.
- **së treti**, në lidhje me kërkesën e Albtelecom për aplikimin e pagesave për Z(P)B përveç pagesës për origjinimin e thirrjeve, AKEP në dokumentin “Qëndrimi i AKEP për komentet e palëve të interesuara” (miratuar me VKD nr. 1650, datë 29.06.2011) është shprehur:

“Në lidhje me këtë çështje AKEP ka bërë sqarimin në dokumentin final se këto tarifa dhe niveli i tyre do të jenë objekt i shqyrtimit dhe miratimit nga AKEP pas propozimit të Albtelecom. Duhet theksuar se asnjë prej palëve të interesuara nuk ka bërë propozime konkrete për nivele të këtyre tarifave”.

Gjithashtu, AKEP në pikën 3 (tre) të vendimit ka vënë detyrimin për Albtelecom që brenda datës 30.07.2011, Albtelecom të depozitojë në AKEP amendimet e nevojshme të ofertës referencë të interkoneksionit për përfshirjen e shërbimeve të zgjedhjes dhe parazgjedhjes së bartësit.

Albtelecom ende nuk ka sjelle propozimin për amendimin e RIO për Z(P)B, propozim i cili mund të përmbaje edhe tarifën e propozuar nga Albtelecom dhe që do jenë objekt shqyrtimi dhe miratimi nga AKEP.

Duke marrë në konsideratë efektet pezulluese të Vendimit nr. 1650, datë 29.06.2011 nga ankimi i Albtelecom, si edhe afatin e implementimit të Z(P)B nga Albtelecom (i ndryshuar me këtë vendim), ky i fundit duhet të zbatohet pikën 3 të Vendimit brenda datës 15.10.2011.

- **së katërti**, në lidhje me kërkesën e Albtelecom për parashikime me të zgjeruara rregullatore mbi kriteret që duhet të plotësojë operatori për tu autorizuar për ofrimin e Z(P)B, AKEP gjykon se, përcaktimet në ANEKSIN 4, (fq. dokumenti 19/20 dhe 20/20), kanë parashikuar kërkesa të detajuara dhe të rëndësishme të cilat janë të mjaftueshme për të krijuar bindjen dhe arsyetuar ligjërisht autorizim nëse një operator i plotëson kushtet ose jo për të ofruar shërbimin e kërkuar në formularin e aplikimit, i cili i përmban kriteret kryesore ligjore dhe rregullatore të cilat kanë të bëjnë me: pajisjen paraprake me autorizim të përgjithshëm (**ofrim rrjeti dhe shërbimesh telefonike**), pajisjen me kod NSPC i cili mundëson identifikimin e sistemit të tij, si dhe kërkesa për zotërimin e kapaciteteve të plota teknike dhe menaxhuese të përcaktuara në dokumentet rregullatore të AKEP si: sistemi i billing-ut për faturimin, realizimi i treguesve të cilesisë, zbatimin e rekomandimeve dhe udhëzimeve të institucioneve ndërkombëtare të cilat ndërtojnë standarde në fushën e komunikimeve elektronike dhe marrjen përsiper nga ana e këtij operatori të interesuar për të zbatuar legjislativonin në fushën e privatësisë dhe sigurisë së informacionit.
- **së pesti**, në lidhje me kërkesën e ankimesit për ndryshimin e afatit 10 ditor në një afat 20 ditor të cilin e referon të parashikuar në nenin 4, pika 3, AKEP konstaton një

“Iajthitje grafik” të kësaj reference pasi në asnjë moment nuk gjen nje përcaktim rregullator të këtij afati në nenin 4, pika 3 te Rregullores i cili parashikon se “Operatori i rrjetit aksesit lejon përdorimin e shërbimit të zgjedhjes së bartësit në fillim të thirrjes, në të gjitha rastet kur pajtimtari formon prefiksin e operatorit të zgjedhur, përveç rasteve kur pajtimtari ka nënshkruar një kontratë me operatorin e rrjetit të aksesit me paketë të veçantë tarifore të përjashtuar nga detyrimi për mundësimin e Z(P)B”,

P Ë R K Ë T O A R S Y E :

Bazuar në pikën 1 të nenit 114 dhe pikën 1 të nenit 115, të Ligjit nr. 9918, nenin 135 e vijues të K.Pr.A, si dhe pikën 17 te nenit 21 të Rregullores së Brendshme,

V E N D O S :

1. Të pranojë pjesërisht kërkesën ankimore nr. 3808 prot, datë 18.08.2011 të Albtelecom sh.a. në lidhje me Vendimin nr.1650, datë 29.06.2011 të KD të AKEP.
2. Të ndryshojë afatin e implementimit të Fazës së parë të Z(P)B, të referuar në dokumentat e miratuar me Vendimin nr.1650, datë 29.06.2011, nga 15.10.2011 në 1.12.2011.
3. Të ndryshojë afatin e referuar në pikën 3 të Vendimit nr.1650, datë 29.06.2011, për depozitim nga Albtelecom në AKEP të amendimeve të ofertës referencë të interkoneksionit për përfshirjen e shërbimeve të zgjedhjes dhe parazgjedhjes së bartësit, nga 30.07.2011 në 15.10.2011.
4. Të gjithë përcaktimet e tjera të Vendimit nr.1650, datë 29.06.2011 dhe dokumentave të miratuar me këtë vendim ngelen të pandryshuar dhe në fuqi.
5. Të njoftohet sipërmarrësi Albtelecom sh.a për zbatimin e këtij Vendimi.
6. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARË:

1. **Alketa MUKAVELATI**
2. **Benon PALOKA**
3. **Zamira NURCE**